

VENDIM

Nr. 1 datë 06/06 /2022

**PËR
NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.70, DT.29.10.2019 TË ASAMBLESË SË
PËRGJITHSHME**

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit nr. 10130, dt. 11.05.2009 "Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit", të ndryshuar, nenit 13 të statutit të Fondit Shqiptar të Zhvillimit miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues Nr.82, dt.17.07.2009, i ndryshuar, Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, Vendimi Nr.70, dt. 29.10.2019 të Asamblesë së Përgjithshme "Për përcaktimin e përfaqësuesve që përfaqësojnë FSHZH në cilësinë e ortakut të vetëm të Shoqërisë Agjencia Ekonomike Mbështetëse sh.p.k (AEM sh.p.k), i ndryshuar, Asambleja e Përgjithshme,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e pikës 1 të Vendimit Nr.70, dt. 29.10.2019 të Asamblesë së Përgjithshme "Për përcaktimin e përfaqësuesve që përfaqësojnë FSHZH në cilësinë e ortakut të vetëm të Shoqërisë Agjencia Ekonomike Mbështetëse sh.p.k (AEM sh.p.k), si më poshtë:

Fondi Shqiptar i Zhvillimit që përfaqëson ortakun e vetëm të Shoqërisë Agjencia Ekonomike Mbështetëse sh.p.k (AEM sh.p.k), do të përfaqësohet në Asambleshë e Përgjithshme të kësaj shoqërie, me përfaqësuesit si më poshtë:

- Drejtori Ekzekutiv
- Zv Drejtori Ekzekutiv për Aktivitetin e Organizatës
- Zv Drejtori Ekzekutiv për Funkcionet e Brendshme
- Drejtori i Departamentit të Zhvillimit Rajonal dhe Kohezionit
- Drejtori i Departamentit të Zhvillimit të Aplikuar dhe Partneritetit

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, i njoftohet të gjithë strukturave dhe depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Dritan AGOLLI

Kryetar

Gentian KERI

Anëtar

Dritan RRESHKA

Anëtar

Fatjon NANAJ

Anëtar

Arben SKËNDERI

Anëtar

A collection of handwritten signatures in blue ink. There are four distinct signatures corresponding to the roles listed: Kryetar, Anëtar, Anëtar, and Anëtar. Below these, there is a large, sweeping scribble that starts from the left and extends towards the right, crossing over the signature lines.